

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/B.r. str. 161

Data/Datum. 08.09.2023

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.09.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.08.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1229, të datës 22.08.2023, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupeve Punuese për hartimin e Projekt-Rregullores për Subvencione

1. Për formimin e Grupit Punuese për hartimin e Projekt-Rregulloreve Komunale për subvencione, në përbërje prej gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë, nga Kuvendi i Komunës: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi, Artan Asllani, Radoman Doderovic, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës: Besnik Osmani, Mimoza Kolshi, Mehmet Gërguri, Besnik Shala, Fatlum Berisha dhe nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriqi.
2. Pjesë e Grupit Punues është edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Shefja e Zyrës Ligjore dhe Zytari i Lartë për Kuvend dhe Komitete.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) dhe dy (2) e vendimit, është hartimi i Projekt-Rregullores për Subvencione.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe publikimit të tij në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupeve Punuese dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.09.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31.08.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1228, të datës 22.08.2023, për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, pas rishqyrtimit dhe procedimit të mëtutjeshëm për miratim, sipas rekomandimeve mbështetur në shkresën Nr. 2251-3/23, të datës 24.05.2023 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me vendimin Nr. 110, i datës 05.05.2023 dhe Planin e Veprimit për Cilësi të Ajrit Nr. 111, i datës 05.05.2023, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit Nr. 08/L-025, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2022), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027

1. Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.
2. Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e veprimit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

